

Blini ME SIGURI në internet - 3D SECURE kartat bankare të EUROSTANDARD BANK SHA SHKUP

Teknologjia "3D Secure" zbatohet për MasterCard® kartat e debitit dhe kreditit të Eurostandard Bank SHA Shkup, që janë siguruar me certifikatat ndërkombëtare prestigjioze të "MasterCard® SecureCode".

"3D Secure" mundëson kontrollimin e **autenticitetit dhe identitetit të përdoruesit të kartës** gjatë realizimit të pagesave ne Internet me kartat MasterCard®, duke dërguar **SMS me fjalëkalimin OTP për një përdorim**, gjatë kohës së realizimit të transaksionit. Për të kompletuar transaksionin ju do të duhet të shënoni fjalëkalimin OTP (që do ta fitoni në telefonin tuaj celular) dhe në këtë mënyrë do të verifikohet autenticiteti i transaksionit.

Përdoruesit nuk do të kenë shpenzime shtesë nga ana e Bankës, për dërgimin e fjalëkalimit.

VËREJTJE: Për të realizuar transaksionet pa problem, klientët duhet të azhurnojnë informatat e kontaktit, më saktësisht të azhurnojnë numrin e telefonit celular në të cilin do të dërgohet mesazhi SMS me fjalëkalimin OTP për një përdorim.


Klientët mund të azhurnojnë të dhënat në ekspoziturën më të afërt ose në sportelet e Eurostandard Bank SHA Shkup, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00.

Të gjitha transaksionet e-commerce **nuk t'i nënshtrohen verifikimit** me OTP. Do të verifikohen vetëm transaksionet për të cilat sistemi do të vlerësojë se janë me rrezik ose jostandarde për përdoruesin.


Shembull i transaksionit e-commerce që do të verifikohet me fjalëkalim OTP:

Hapi 1: Ju do të fitoni një mesazh SMS me përmbajtjen e fjalëkalimit numerik OPT (p.sh. 468848)

Hapi 2: Ju duhet të shënoni fjalëkalimin numerik OPT të fituar si një mesazh SMS në telefonin tuaj celular.



MasterCard.
SecureCode.

 CaSys
International

MK ▼

Автентикација со еднократна лозинка (OTP)

Испратена е еднократна лозинка на Вашиот мобилен.

Трговец: Modirum Coffeehouse
Износ: USD 9.00
Датум: 20170316 10:30:11
Број на картичка: XXXX XXXX XXXX 6335
Лична порака:
Еднократна лозинка:

[Помош](#) [Побарај нова лозинка OTP](#) [Откажи](#)

За помош, контактирајте го Центарот за поддршка на задниот дел на картичката.

MasterCard
SecureCode

CaSys International

Identifikimi me fjalëkalimin për një përdorim (OPT)
Në numrin e telefonit tuaj u dërgua një fjalim për një përdorim.

Tregtari: Modirum Coffeehouse

Shuma: USD 9.00

Data: 20170316 10:30:11

Numri i kartës: XXXX XXXX XXXX 6335

Mesazhi personal:

Fjalëkalimi për një përdorim:

Ndihmë Kërko fjalëkalim të ri OPT Anulo Vazhdo
Për ndihmë kontaktoni me qendrën e asistimit, në pjesën e pasme të kartës.

Mekanizmi i mbrojtjes me teknologjinë "3D Secure" ka për qëllim mbrojtjen nga vjedhja të identitetit të përdoruesve të kartelave dhe mbrojtje nga keqpërdorimi i të dhënave të kartave (numri i kartës, data e skadimit dhe kodi CVC/CVV2).

Bëhet fjalë për një teknologji të avancuar, që është standardi më i lartë në fushën e mbrojtjes së përdoruesve të kartave në rastet e pagesave në Internet.

Të gjithë përdoruesit e MasterCard® - kartës së debitit ose kreditit të Eurostandard Bank SHA Shkup janë regjistruar dhe kartat e tyre kanë standardin e sigurisë "3D Secure" për mbrojtje gjatë pagimit në Internet, që do të thotë se nuk ka nevojë për regjistrim ose dorëzim kërkesë në bankë. E vetmja gjë që duhet të bëni është të azhurnoni në bankë numrin e telefonit tuaj celular.

EUROSTANDARD Bank SHA Shkup